

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE SHKODËR
NOTER LUMTURI HOXHA



Nr.prot. 3

Dt.16.04.2024

VENDIM NDREQJE GABIMI MATERIAL

**Ne Aktin me Lende „Redaktim dhe Vertetim I Akteve te SH.P.K-ve nr. Rep
1264.kol. 478 date 05.04.2024**

Ne Shkoder, sot me date 16.04.2024 (dymije e njezet e kater), une Notere Lumturi Hoxha, Notere prane Dhomes se Noterise Shkoder, me seli ne rrugen Don Bosco Shkoder, sipas kerkeses se bere nga **Kristjan Lazri e Pashko Koja, ne cilesine e themeluesve te ECONATYR sh.p.k.**, te cilet kerkuan nga une noterja korrigjimin e te nenit 5 dhe 12 ne Aktin Noterial „Redaktim dhe Vertetim I SHPK-ve“ nr.rep. 1264 nr.kol. 478 hartuar ne dt. 05.04.2024, nga Notere Lumturi Hoxha.

VEREJ SE:

Ne aktin noterial te sipercituar, konkretisht ne nenin 5 te aktit te themelimit dhe ne nenin 12 te statutit, gjenden te percaktuara kuotat ne kete menyre:

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte percaktuar ne shumen 100.000 (njqind mije) leke.

Kapitali themeltar eshte i perbere nga 10 kuota me nje vlere nominale (dhjetemijë lekë secila) si me poshte:

KRISTJAN LAZRI

- 3 KUOTA ME VLERE 30.000 LEKE

OSE SHPREHUR NE PERQINDJE:

KRISTJAN LAZRI

- 30 %

PASHKO KOJA

- 7 KUOTA ME VLERE 70.000 LEKE

OSE SHPREHUR NE PERQINDJE:

PASHKO KOJA

- 70 %

Pasi administrova kerkesen e paraqitur nga kerkuesi une notere deklaroj se, bej ndreqjen e ketij gabimi material, duke sakesuar qe permbajtja e nenit 5 ne aktin e themelimit dhe neni 12 I Statutit te Econatyr sh.p.k, hartuar me aktin notarial nr.1264 nr.kol. 478 dt. 05.04.2024 ndryshon me permbajtje si me poshte:

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte percaktuar ne shumen 100.000 (njqind mije) leke.

Kapitali themeltar eshte i perbere nga 2 kuota me nje vlere nominale (dhjetemijë lekë secila) si me poshte:

KRISTJAN LAZRI

- 1 KUOTE ME VLERE 30.000 LEKE

OSE SHPREHUR NE PERQINDJE:

KRISTJAN LAZRI

- 30 %

PASHKO KOJA

- 1 KUOTE ME VLERE 70.000 LEKE

OSE SHPREHUR NE PERQINDJE:

PASHKO KOJA

- 70 %

PER KETO ARSYE:

Ne rrethanat kur une u vura ne dijeni per nje fakt te tille, bazuar ne Nenin 107 te Ligjit 110/2018 „Per Noterine“ I ndryshuar, „Ndreqja e gabimeve ne aktet e noterit“,

Ku Thuhet:

„1. Në aktin noterial lejohet të bëhen ndreqje në rastet kur:

a) noteri konstaton gabime materiale, të cilat nuk cenojnë përmbajtjen thelbësore të aktit. Në këtë rast, noteri procedon me fshirjen dhe shkruan qartë mbi pjesën e fshirë, ku vendos edhe nënshkrimin e tij dhe vulën e njomë, ose realizon korrigjimin me anë të

një shtese në një vërtetim të veçantë për ndreqje gabimi, i cili i bashkëngjitet origjinalit. Të gjitha palët që kanë marrë kopje të origjinalit, duhet të informohen mbi korrigjimin e kryer;

b) nëse lind nevoja për të hequr, shtuar, ndryshuar gabimet e konstatuara në aktin apo veprimin noterial përkatës, ndryshimi i të cilave është thelbësor për përmbajtjen e aktit apo veprimit noterial, ato vihen në kllapa, nënvizohen dhe në vijim përmendet dhe specifikohet ndryshimi i bërë dhe përmbajtja e hequr. Përbri tyre nënshkruajnë palët dhe noteri. Në rastin e lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë, nënshkruan kërkuesi...“

Mua si notere me lind e drejta e korigjimit të gabimit material të bërë në nenin 5 dhe 12 të Aktit Redakrim dhe Vertetim I sh.p.k. nr.rep. 1264 nr.kol. 478 dt. 05.04.2024. Në bazë të Neni 107 i Ligj nr. 110/2018 „PËR NOTERINË“ Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës. Në keto kushte ;

VENDOSA PRANIMIN E KERKESES

Dhe realizimin e ndreqjet të gabimit të material të bërë në nenin 5 të Aktit të themelimit dhe në nenin 12 të Statutit të Shoqërisë ECONATYR sh.p.k. hartuar me Aktin Noterial « Redaktim dhe Vertetim i Akteve të sh.p.k.-Ve » nr.rep. 1264 nr.kol. 478 dt. 05.04.2024;

E konkretisht, neni 5 dhe neni 12 me përmbajtje si me poste ndryshon nga:

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është percaktuar në shumën 100.000 (njqind mijë) leke.

Kapitali themeltar është i përbërë nga 10 kuota me një vlerë nominale (dhjetemijë lekë secila) si me poshte:

KRISTJAN LAZRI

- 3 KUOTA ME VLERE 30.000 LEKE

OSE SHPREHUR NE PERQINDJE:

KRISTJAN LAZRI


- 30 %

PASHKO KOJA

- 7 KUOTA ME VLERE 70.000 LEKE

OSE SHPREHUR NE PERQINDJE:

PASHKO KOJA



- 70 %

në:

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte percaktuar ne shumen 100.000 (njqind mije) leke.
Kapitali themeltar eshte i perbere nga 2 kuota me nje vlere nominale (dhjetemijë lekë secila) si me poshte:

KRISTJAN LAZRI

- 1 KUOTE ME VLERE 30.000 LEKE

OSE SHPREHUR NE PERQINDJE:

KRISTJAN LAZRI

- 30 %

PASHKO KOJA

- 1 KUOTE ME VLERE 70.000 LEKE

OSE SHPREHUR NE PERQINDJE:

PASHKO KOJA

- 70 %

Ky vendim ju komunikua paleve pjesemarrrese ne akt, Dhomes Kombetare te Noterise dhe behet pjese integrale e pandare e ketij akti.

NOTERE

LUMTURI HOXHA



LIGJ
Nr. 110/2018
PËR NOTERINË

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

Neni 107

Ndreqja e gabimeve në aktet dhe veprimet noteriale

1. Në aktin noterial lejohet të bëhen ndreqje në rastet kur:

a) noteri konstaton gabime materiale, të cilat nuk cenojnë përmbajtjen thelbësore të aktit. Në këtë rast, noteri procedon me fshirjen dhe shkruan qartë mbi pjesën e fshirë, ku vendos edhe nënshkrimin e tij dhe vulën e njomë, ose realizon korrigjimin me anë të një shtese në një vërtetim të veçantë për ndreqje gabimi, i cili i bashkëngjitet origjinalit. Të gjitha palët që kanë marrë kopje të origjinalit, duhet të informohen mbi korrigjimin e kryer;

b) nëse lind nevoja për të hequr, shtuar, ndryshuar gabimet e konstatuara në aktin apo veprimin noterial përkatës, ndryshimi i të cilave është thelbësor për përmbajtjen e aktit apo veprimit noterial, ato vihen në kllapa, nënvizohen dhe në vijim përmendet dhe specifikohet ndryshimi i bërë dhe përmbajtja e hequr. Përbri tyre nënshkruajnë palët dhe noteri. Në rastin e lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë, nënshkruan kërkuesi;

c) në të gjitha rastet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, fjalët apo fjalia e hequr nuk ka vlerë juridike dhe nuk merret parasysh në tërësinë e aktit. Kur akti përbëhet nga disa faqe, ato duhen numëruar e lidhur, duke specifikuar edhe numrin përkatës të faqeve.

2. Rregulla të detajuara për ndreqjen e gabimeve në aktet dhe veprimet noteriale përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Drejtësisë, me propozim të Dhomës Kombëtare të Noterisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE SHKODËR

NOTER LUMTURI HOXHA
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
SHKODER, RR. DON BOSKO
TEL: 0692923334

REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SH.P.K-VE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE SHKODËR

Nr. repertori: 1264

Nr koleksionit: 478

Shkoder më 05/04/2024

LUMTURI HOXHA

K373100201

NJESIA ADMINISTRATIVE SHKODER,
RR. DON BOSKO

FATURE TATIMORE SHITJE

Di: 05/04/2024 15:07:00 Nr. 1329/2024

KB: pp586lx928 OP: il129qt183 TCR: cg313zu031

Përshkrimi	Sasia	Çmimi	Total
REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE (SHPK)	1.00	X 20,000.00	24,000.00
P200-Pulla 200			
		1.00 X 200.00	200.00
TOTALI			24,200.00 (ALL)

MENYRA E PAGESES:

Shk.TVSH% Baze VI.TVSH
20% 20,200.00 4,000.00



Lumturi
Hoxha

Firmosur elektronikisht nga
NISA me certifikaten
:Lumturi Hoxha
Data: 2024.04.05
15:07:49+02:00

Ligjet referuese:

- Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 1 fletë

NLSF: 69AFB31G0DFB514DF51CEE26076010DF

NIVF: 20C6725C-2ED4-4928-9BAD-1B3E0AEA7C17

Powered by Helius Systems | www.helius-software.com



**TAKSA E PULLËS
U RAGUA**

**AKTI I THEMELIT
DHE STATUTI I**

**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"ECONATYR SH.P.K"**

Sot, më datë 5 Prill 2024, ditën e Premte, para meje Notere Lumturi Hoxha, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Shkodër, me zyrë në adresën Shkoder, Njesia Administrative Shkoder, Rr. Don Bosko, u paraqit personalisht:

THEMELUES:

Kristjan Lazri, atësia Ndreke, amësia Rregjina, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në SHKODËR, me adresë Damnore 03420011; Nd. 13; H. 1; Guri I Zi; Rrencë; 4016; Shkodër, lindur më 24/09/1993, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031372618 dhe nr. personal J30924030T.

THEMELUES:

Pashko Koja, atësia Mark, amësia Gjelina, shtetas Shqiptar, lindur në Bërdicë, Shkodër dhe banues në SHKODËR, me adresë Ded Gjon Luli 03400023; Nd. 7; H. 1; Bërdicë; Bërdice E Madhe; 4018; Shkodër, lindur më 30/04/1997, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032158678 dhe nr. personal J70430038K.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Statutin dhe Aktin e Themelimit te Shoqerise ECONATYR", bashkëlidhur.

Unë Noterja verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpuj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

THEMELUES

Kristjan Lazri

THEMELUES

Pashko Koja

**NOTERE
LUMTURI HOXHA**





A2024043760050772612

AKT THEMELIMI**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR****“ECONATYR” SH.P.K.**

Sot, ne Shkoder, me date 5 Prill 2024, me cilesine e ortakeve themelues te shoqerise:

1-Kristjan LAZRI, atësia Ndreke,amësia Rregjina,shtetas Shqiptar,lindur në Shkodër e banues në Shkodër, adresën Damnore 03420011; Nd.13; H.1; Guri i Zi; Rrencë; 4016; Shkodër, lindur më 24/09/1993, gjendja civile “i Divorcuar”, identifikuar me Pasaporte Biometrike Nr.BI6018257 dhe nr.personal **J30924030T**.

2- Pashko KOJA, atësia Mark,amësia Gjelina,shtetas Shqiptar,lindur në Bërdicë, Shkodër e banues në Shkodër,adresën Ded Gjon Luli 03400023; Nd.7; H.1; Bërdicë Bërdice e Madhe; 4018; Shkodër, lindur më 30/04/1997,gjendja civile “Beqar”, Identifikuar me Pasaporte Biometrike nr.BJ6855488 dhe nr.personal **J70430038K**.

Ka vendosur themelimin e shoqerise “**ECONATYR**” sh.p.k.

Me nenshkrimin e ketij Akti Themelimi te nje shoqerie tregtare, nenshkruetit dhe themeluesit e saj marrin persiper te realizojne e te respektoje te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga klauzolat e meposhtme, te cilat do te specifikohen gjeresisht ne Statutin e shoqerise:

THEMELIMI I SHOQERISE

Ne mbeshtetje dhe zbatim te dispozitave te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" si dhe ligjin nr. 9723 dt. 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit” te ndryshuar, themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar “**ECONATYR**” sh.p.k (me poshte ne kete akt e quajtur "Shoqeria") nga Ortaku i vetem themelues te saj.

FORMA E SHOQERISE



A2024043760030772612

Shoqëria **“ECONATYR” sh.p.k**, me poshte e referuar si **“Shoqëria”**, eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar krijuar ne baze te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 **“Per tregtaret dhe shoqerite Tregtare”**, dhe rregullohet prej ketij ligji, dhe statutit te shoqerise si dhe prej cdo dispozite tjeter ligjore te aplikueshme.

II EMRI I SHOQERISE, SELIA, OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA

Neni 1

Emri

Emri i shoqerise eshte **“ECONATYR” sh.p.k**. Ne cdo dokument, fature, reklame dhe publikime emri i shoqerise do te pasohet nga:

- (i) fjala **“me pergjegjesi te kufizuar”** apo **“sh.p.k”**
- (ii) numri i saj i regjistrimit
- (iii) selia

Neni 2

Selia

Selia administrative e shoqerise do te jete ne: Rrence-Guri i Zi-Shkoder, Zona Kadastrale **3168**, Pasuria Nr.**107/30**.

Neni 3

Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise **“ECONATYR” sh.p.k** eshte **pa afat**. Ortaket kane te drejte te kufizojë kete afat duke zbatuar procedurat per ndryshimin e Statutit.

III OBJEKTI I SHOQERISE

Neni 4

Objekti

1.1. Objekti i veprimtarise se shoqerise ne perputhje me legjislacionin shqiptar do te jete:

- *Projektim, ndertim dhe mirembajtjen e centraleve gjeneruese per prodhimin e energjise*



A2024043760050772612

elektrike nga burime te rinovueshme si dielli, era dhe uji, ndertimin dhe mirembajtjen e impianteve fotovoltaike dhe eolike per gjenerimin e energjise elektrike dhe ndertimin e mirembajtjen e impianteve te tjera per prodhimin e energjise nga burime alternative. Shitjen e energjise elektrike te prodhuar tek persona te tretet, publik apo privat. Projektim, zbatim, mirembajtje dhe asistence teknike e impianteve elektrike ne pergjithesi per tensionin e mesem, te ulet dhe speciale, impiante klimatizimi, automatizimi industrial, aspirimi, impiante ndricimi etj.

- Tregtim me shumicë e pakicë Imp.-Exp.i Paneleve Diellore dhe aksesoreve e pjeseve funksionale te tyre.
- Tregtim me shumice e pakice Imp.-Exp.i Pompave te Nxemjes, Kondicioner, Mulli Ere, Bateri, Inverter, Automat, Kabell, Struktura, si dhe aksesoret paisjet, materialet dhe pjeset e nderrimit që i pershtaten funksionit të tyre.
- Si dhe çdo veprimtari tjeter qe bashkohet me veprimtarite e mesiperme dhe qe konsiderohet i pershtatshem e me leverdi per rritjen e zhvillimin e metejsheem te aktivitetit te shoqerisë.
- Përveç veprimtarive te parashikuara me lart, ne veprimtarine e shoqerise do te hyj edhe cdo veprimtari qe do te konsiderohet nga ortaket si e nevojshme dhe e pershtatshme per arritjen e objektit te shoqerise dhe qe nuk vjen ne kundërshtim me Ligjin Shqiptar.

IV KAPITALI THEMELTAR DHE ORGANIZIMI

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte percaktuar ne shumen 100.000 (njqind mije) leke.

Kapitali themeltar eshte i perbere nga 10 kuota me nje vlere nominale (dhjetemijë lekë secila) si me poshte:

KRISTJAN LAZRI

- 3 KUOTA ME VLERE 30.000 LEKE



A2024043760050772612

OSE SHPREHUR NE PERQINDJE:

KRISTJAN LAZRI

- 30 %

PASHKO KOJA

- 7 KUOTA ME VLERE 70.000 LEKE

OSE SHPREHUR NE PERQINDJE:

PASHKO KOJA

- 70 %

Neni 6

ORGANIZIMI

Shoqeria do te drejtohet nga nje Administrator. Kete detyre do ta kryej per periudhen e pare prej **5 vjetesh**, i cili do te ushtroje te gjitha kompetencat per administrimin e veprimtarise se perditshme te shoqerise, per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise.

ORTAKET

KRISTJAN LAZRI

Kristjan Lazri

PASHKO KOJA



A202404376005072612

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ECONATYR” SH.P.K

SHKODER 2024



A2024043760050772612

KAPITULLI I

DISPOZITA TE PERGJITHISHME

Sot ne Shkoder, me date 5 Prill 2024, ditën e Premte, ne mbeshtetje te ligjit nr . 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe Ligjit nr. 9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit” I ndryshuar, qe rregullojne marredheniet tregtare dhe funksionimin e shoqerive, ne cilesine e themeluesve dhe ortakeve:

1-Kristjan LAZRI,atësia Ndrekë,amësia Rregjina,shtetas Shqiptar,lindur në Shkodër e banues në Shkodër, adresën Damnore 03420011; Nd.13; H.1; Guri i Zi; Rrencë; 4016; Shkodër, lindur më 24/09/1993,gjendja civile “i Divorcuar”,identifikuar me Pasaporte Biometrike Nr.BI6018257 dhe nr.personal **J30924030T**.

2- Pashko KOJA, atësia Mark,amësia Gjelina,shtetas Shqiptar,lindur në Bërdicë, Shkodër e banues në Shkodër,adresën Ded Gjon Luli 03400023;Nd.7;H.1;Bërdicë Bërdice e Madhe; 4018;Shkodër, lindur më 30/04/1997, gjendja civile “Beqar”, Identifikuar me Pasaporte Biometrike nr.BJ6855488 dhe nr.personal **J70430038K**.

ne zbatim dhe ne perputhje me kerkesat e Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe Ligjit nr. 9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit” i ndryshuar, harton kete statut te shoqerise “**ECONATYR**” **SH.P.K**.

KREU I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK, AFATET

Shoqeria “ECONATYR” Sh.p.k. nepermjet ketij Statuti, ne perputhje me Aktin e Themelimit per krijimin e saj, bazuar ne legjislacionin shqiptar ne fuqi, rregullon gjendjen juridike te shoqerise, marredheniet e saj me te tretet, te dhenat me rendesi per poziten juridike te ortakeve ne raport me shoqerine dhe te tretet, organet drejtuese dhe kompetencat e tyre, organizimin dhe objektin e



A2024043760050772612

veprimtarise se shoqerise, si dhe ceshtje te tjera me rendesi per mbarevajtjen e Shoqerise "ECONATYR" sh.p.k.

Çdo ceshtje qe nuk eshte shprehimisht e trajtuar ne kete Statut, do te interpretohet ne perputhje me frymen e tij, nisur nga parimet e mirebesimit, bashkepunimit dhe interesit reciprok te ortakeve te shoqerise.

NENI 1

OBJEKTI I SHOQERISE

1.2. Objekti i veprimtarise se shoqerise ne perputhje me legjislacionin shqiptar do te jete:

- *Projektim, ndertim dhe mirembajtjen e centraleve gjeneruese per prodhimin e energjise elektrike nga burime te rinovueshme si dielli, era dhe uji, ndertimin dhe mirembajtjen e impianteve fotovoltaike dhe eolike per gjenerimin e energjise elektrike dhe ndertimin e mirembajtjen e impianteve te tjera per prodhimin e energjise nga burime alternative. Shitjen e energjise elektrike te prodhuar tek persona te tretet, publik apo privat. Projektim, zbatim, mirembajtje dhe asistence teknike e impianteve elektrike ne pergjithesi per tensionin e mesem, te ulet dhe speciale, impiante klimatizimi, automatizimi industrial, aspirimi, impiante ndricimi etj.*
- *Tregtim me shumicë e pakicë Imp.-Exp.i Paneleve Diellore dhe aksesoreve e pjeseve funksionale te tyre.*
- *Tregtim me shumice e pakice Imp.-Exp.i Pompave te Nxemjes, Kondicioner, Mulli Ere, Bateri, Inverter, Automat, Kabell, Struktura, si dhe aksesoret paisjet, materialet dhe pjeset e nderrimit që i pershtaten funksionit të tyre.*
- *Si dhe çdo veprimtari tjetër qe bashkohet me veprimtarite e mesiperme dhe qe konsiderohet i pershtatshem e me leverdi per rritjen e zhvillimin e metejsheem te aktivitetit te shoqerisë.*
- *Perveç veprimtarive te parashikuara me lart, ne veprimtarine e shoqerise do te hyj edhe cdo veprimtari qe do te konsiderohet nga ortaket si e nevojshme dhe e pershtatshme per arritjen e*



A2024043760050772612

objektit të shoqërisë dhe që nuk vjen në kundërshtim me Ligjin Shqiptar.

NENI 2

EMERTIMI DHE SELIA JURIDIKE E SHOQËRISË

- 2.1. Emertimi i Shoqërisë është: “ECONATYR” sh.p.k
- 2.2. Selia juridike e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rrencë-Guri i Zi-Shkoder, Zona Kadastrale 3168, Pasuria Nr.107/30.
- 2.3. Shoqëria mund të krijojë adresë sekondare, filiale, zyrë përfaqësimi e agjenci në Tiranë, qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.
- 2.4. Adresa e ortakëve në marrëdhëniet me Shoqërinë do të jetë ajo që rezulton të shënuar në librin e Shoqërisë.

NENI 3

REGJIMI JURIDIK

- 3.1. Forma juridike e shoqërisë është **shoqëri me përgjegjësi të kufizuar**. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit, si dhe legjisllacionit në fuqi. Ligji i aplikueshëm për zgjidhjen e çdo mosmarrvëshje eventuale që lind gjatë aktivitetit të shoqërisë është ligji shqiptar.
- 3.2. Kompetente për zgjidhjen e mosmarrvëshjeve të parashikuara në paragrafin e mësipërm është Gjykata e Shkalles së Parë e Juridiksionit të Përgjithshme Shkoder.
- 3.4. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendren Kombëtare të Biznesit.

NENI 4

KOHEZGJATJA

- 4.1. Kohezgjatja e veprimtarisë së shoqërisë “ECONATYR” shpk është **pa afat**. Ortaket kanë të



A2024043760030772612

drejte te kufizojne kete afat duke zbatuar procedurat per ndryshimin e Statutit.

KREU II

ORGANET DREJTUESE, MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE,

EKSPERTET

NENI 5

ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese te shoqerise "ECONATYR" shpk jane:

- 1) **Asambleja e Pergjithshme**, e cila eshte organi me i larte vendim marres.
- 2) **Administratori** i Shoqerise, qe caktohet nga Asambleja e Pergjithshme dhe eshte percaktuar te jete **Kristjan Lazri**.

NENI 6

MARRJA E VENDIMEVE

- 6.1. Asambleja, rregullisht e thirrur dhe e perbere prej ortakeve te shoqerise, perfaqeson vullnetin e ortakeve. Vendimet e marra prej saj, per sa kohe qe jane te vlefshme ne perputhje me ligjin dhe me kete statut, detyrojne te gjithë anetaret e asamblese edhe pse jo te pranishem dhe jo dakort.
- 6.2. Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e asamblese personalisht dhe disponon nje numer votash te barabarta me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Cdo ortak ka te drejte te perfaqesohet ne Asamble nga persona te trete duke u leshuar atyre prokure te posacme per cdo mbledhje te asamblese.
- 6.3. Vendimet, ne mungese te prezences se ortakeve, mund te merren pas konsultimit me shkrim te tyre, ne rast se te gjithë ortakët miratojne me shkrim permbajtjen e konsultimit. Ne kete rast zbatohen procedurat e percaktuara nga ligji tregtar.
- 6.4. Ortaket lajmërohen per zhvillimin e mbledhjes se Asamblese me shkrese apo me mesazh elektronik, i cili duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites jo me



A2024043760030772612

vone se 7 dite perpara dates se mbledhjes.

6.5. Mbledhja e asamblese mund te thirret nga Administratori i shoqerise, nga nje ose disa prej ortakëve te shoqerise qe zoterojne te pakten 5% te pjeseve te kapitalit themeltar.

6.6. Cdo mbledhje e asamblese e thirrur ne menyre te parregullt, mund te anulohet. Anullimi nuk ka vlere, ne rast se te gjithë ortakët jane te pranishem ose te perfaqesuar.

NENI 7

KOMPETENCAT E ASAMBLES SE PERGJITHSHME

7.1 Asambleja e pergjithshme, pervec te tjerave, eshte i vetmi organ qe vendos per:

- emerimin ose shkarkimin e administratoreve, eksperteve kontabel te autorizuar dhe likujduesve;
- percaktimin e shperblimeve per administratorin, ekspertin kontabel dhe likujduesve;
- percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te te ecurise se veprimtarise;
- miratimin e raporteve te administrimit dhe te kontrollit;
- miratimin e llogarive vjetore, disponimin e fitimit, etj;
- ndryshimet e statutit;
- zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit themeltar;
- pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- perfaqesimin e shoqerise ne Gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet;
- zgjatjen e kohes se veprimtarise se shoqerise apo prishjen e saj dhe kalimin ne proces likuidimi;



A2024043760050772612

NENI 8

KUORUMI

- 8.1.** Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme ne qofte se jane te pranishem ose te perfaqesuar nje ose disa ortake qe zoterojne mbi 30% te pjeseve te kapitalit themeltar. Ne rastet kur Asambleja e Pergjithshme duhet te vendose per ceshtje si: *Ndryshimin e Statutit, Zmadhimin ose Zvogelimin e kapitalit te rregjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise* ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se 50% te kapitalit jane te pranishem.
- 8.2.** Ne qoftese mbledhja e Asamblese se Pergjithshme nuk realizohet per mungese kuorumi, thirret mbledhja e dyte brenda 30 diteve me te njejtin rend. Edhe ne kete rast vendimet te vlefshme merren vetem nese eshte formalizuar kuorumi i nevojshem ne varesi te ceshtjes, rend dite.
- 8.3.** Ndryshimet e statutit, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet, zmadhimi apo zvogelimi i kapitalit te rregjistruar, shperndarja e fitimeve riorganizimi apo prishja e shoqerise dhe kalimi ne proces likuidimi, shnderrimi ne nje forme tjeter, vendosen ne mbledhjen e asamblese vetem kur kuorumi i kerkuar perbehet ortaket qe zoterojne me shume se $\frac{1}{2}$ e kapitalit themeltar dhe vendos me $\frac{3}{4}$ e votave te ortakeve pjesemarres.
- 8.4.** Asambleja drejtohet nga nje anetar i zgjedhur nga ortaket e pranishem. Te gjitha vendimet e Asamblese transkriptohen dhe ruhen ne rregjistrat e shoqerise. Ne rastet e percaktuara me ligj, vendimet e asamblese duhet te rregjistrohen ne Qendren Kombetare te Biznesit.
- 8.5.** Dispozitat e mesiperme ne lidhje me menyren dhe kuorumin e kerkuar per marrjen e vendimeve, zbatohen ne rast se shoqeria do te zoterohet nga me shume se nje Ortak.

NENI 9

ADMINISTRATORI

- 9.1.** Administrator i shoqerise "ECONATYR" Shpk do te jete **Kristjan LAZRI**, atësia Ndrejë,



A2024043760050772612

anësia Rregjina, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër e banues në Shkodër, adresën Damnore 03420011, Nd.13; H.1; Guri i Zi; Rrencë; 4016; Shkodër, lindur më 24/ 09/1993, gjendja civile “i Divorcuar”, identifikuar me Pasaporte Biometrike Nr.BI6018257 dhe nr.personal **J30924030T**.

9.2. Afati i këtij mandati fillon me regjistrimin e këtij Statuti ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe vazhdon **5 vjet**, me te drejte rizgjedhjeje.

NENI 10

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

10.1. Administratori drejton gjithë veprimtarinë e Shoqërisë ne pikepamjen tekniko-organizative, ka te gjitha kompetencat per te vendosur ne lidhje me aktivitetin e zakonshem dhe te perditshem te shoqërisë. Administratori gezon te drejta te plota ne vendim-marrje dhe gezon kompetenca te plota, pervec atyre qe ky statut apo ligji ia njohin Asamblese se Pergjithshem apo Ortakut te Vetem.

10.2. Te Drejta dhe Detyrimet e Administratorit te shoqërisë:

- të kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme apo Ortaku i Vetem;
- përfaqëson shoqërinë tregtare; kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme apo Ortakut te Vetem për miratim;
- krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;



A202404376005072612

- raporton përpara asamblesë së përgjithshme apo Ortakut të Vetem në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- administratori është i detyruar të thërrase asamblenë e përgjithshme për sa parashikon ky statut ose ligji.

NENI 11

EKSPERTET KONTABEL TE AUTORIZUAR

Ne rast se Asambleja e Përgjithshme e gjykon të arsyeshme ose nese kerkohet ne menyre te shprehur nga ligji, kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar. Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kushte si dhe emerimi.

KREU III

MJETET E SHOQERISE, KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

NENI 12.

KAPITALI THEMELTAR

- 12.1. Kapitali themeltar i Shoqerise "ECQONATYR" shpk është **100.000,00 LEKE** Leke (njqind mijë).
- 12.2. Kapitali themeltar është i perbere nga 10 kuota me nje vlere nominale (dhjetemije leke secila) si me poshte:

KRISTJAN LAZRI

- 3 KUOTA ME VLERE 30.000 LEKE

OSE SHPREHUR NE PERQINDJE:

KRISTJAN LAZRI

- 30 %

PASHKO KOJA



A2024043760050772612



- 7 KUOTA ME VLERE 70.000 LEKE

QSE SHPREHUR NE PERQINDJE:

PASHIKO KOJA

- 70 %

Pronësia mbi kuotat e shoqërisë, përmban aderimin me të drejta të plota në statutin e shoqërisë nëpërmes përfaqësimit në Asamblene e Ortakeve.

NENI 13

KUOTAT E KAPITALIT

- 13.1. Kuotat e kapitalit themeltar jane emerore dhe te transferueshme.
- 13.2. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie, ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve dhe nepermjet paraardhesve dhe pasardhesve.
- 13.3. Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen te treteve vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe zoterojne 3/4 e pjeseve dhe me kushte jo me te favorshme se ato me te cilat ju jane ofruar me pare ortakeve te tjere duke respektuar te drejten e parablerjes se ortakeve.

NENI 14

FONDET E SHOQERISE

- 14.1. Shoqeria kryen veprimtarine e saj me mjetet e investuara ne fondet e saj dhe me mjete te tjera. Ajo eshte e detyruar qe vellimin e punes se saj ta ushtroje ne vartesi me shumen e mjeteve te investuara ne fondin themeltar te Shoqerise dhe nga shuma e mjeteve te reserves.

Shoqeria percakton fondet e meposhtme :

1. Fondin themeltar

2. Fondin rezerve

- 14.2. Per ushtrimin e veprimtarise se saj Shoqeria mund te percaktoje dhe fonde te tjera.

NENI 15

FONDI THEMELTAR



A2024043760050772612

- 15.1. Fondi themeltar formohet nga mjetet e investuara nga ortaket dhe nga mjetet e tjera ne para ose ne forme tjeter te investuara.
- 15.2. Shoqeria shfrytezon fondin themeltar per ushtrimin e veprimtarise se saj, per investime ne fondet e personave te tjere juridike dhe fizike si dhe per te perballuar rreziqet pas shfrytezimit te mjeteve te reserves.
- 15.3. Gjithashtu mund ti shfrytezoje edhe per destinime te tjera sipas interesit te shoqerise.

NENI 16

FONDI REZERVE

- 16.1. Fondi rezerve i shoqerise formohet nga nje pjese e fitimit qe shoqeria realizon gjate veprimtarise se saj. Ai percaktohet me nje vendim te vecante te Asamblese se Ortakeve Themelues. Fondi rezerve mund te perdoret edhe per destinacione te tjera qe jane perputhje me interesat e shoqerise

KREU IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE, DIVIDENTET

NENI 17

VITI FINANCIAR

- 17.1. Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.
- 17.2. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht, nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga asambleja me shumicen e ortakeve qe zoterojne mbi 1/2 e kapitalit themeltar.
- 17.3. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati te caktuar prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

NENI 18

LLOGARITE FINANCIARE



A202404376005072612

18.1. Ne fund te cdo viti kalendarik duhet te hartohet nje bilanc si dhe nje llogaritje te fitimeve dhe humbjeve. Me kete duhet te ngarkohen eksperte (keshilltare taksash revizore etj).

18.2. Forma e bilanceve dhe librave te llogarise qe do te mbaje shoqeria, percaktohen nga Asambleja e Pergjithshme.

NENI 19

DIVIDENTET

19.1. Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimeve, Asambleja e Pergjithshme percakton pjesen qe u takon ortakeve ne formen e dividenteve. Fitimi, qe do te ndahet midis ortakeve, ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar, perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te domosdoshem dhe nga ana tjeter i jane zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme.

KREU V

KUFIZIMI I AFATIT, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

NENI 20

NDRYSHIMET E AFATIT

20.1. Kufizimi apo zgjatja e afatit te aktivitetit te shoqerise mund te vendoset nga Asambleja e Ortakeve me shumicen e ortakeve qe zoterojne mbi 3/4 e kapitalit themeltar.

NENI 21

PRISHJA E SHOQERISE

21.1. Shoqeria priset ne perputhje me kushtet e percaktuara ne kete statut, me vendim te Asamblese se Ortakeve me kerkesen e 3/4 te pjesmarrjes ne kapitalin themeltar.

21.2. Shkaqet e prishjes se Shoqerise;

a. kur mbaron kohezgjatje e parashikuar ne themelimin e saj;

b. me vendim te Asamblese se Pergjithshme;



A2024043760050772612

- c. me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d. nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne Q.K.B;
- e. me Vendim Gjykate;

Shoqeria nuk priset kur njeri nga ortakët falimenton, behet i paafte ose vdes.

NENI 22

LIKUIDIMI I SHOQERISE

- 22.1.** Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi Asambleja emeron nje ose disa likuidues te cilet i paraqesin asaj/atij raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe te pasivitetit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatin e domosdoshem te perfundimit te tyre.
- 22.2.** Ne fund te procesit te likuidimit Asambleja me shumicen e ortakëve qe zoterojne mbi 3/4 e kapitalit themeltar vendos, mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise te punes se likuiduesit dhe mbylljen e procesit te likuidimit.
- 22.3.** Pas pagimit te kreditorëve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndermjet ortakëve proporcionalisht me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin themeltar dhe njofton Q.K.B per perfundimin e likuidimit dhe kerkon c'rregjistrimin e Shoqerise.

NENI 23

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR

23.1 Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimit të ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.

23.2 Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me



A2024043760050772612

vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

KREU VI

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 24

INTERPRETIMET STATUTORE

- 24.1. Pavlefshmeria e dispozitave te vecanta te kesaj marreveshje nuk e prek teresine e saj vepruese. Ne vend te dispozitave te pavlefshme ose per mbushjen e hapsirave statutore, ortaket bien dakord per nje rregullim te pershtatshem, ne perputhje me qellimin e hartimit te ketij statuti, duke ruajtur interesat e perbashketa.
- 24.2. Per gjithçhka jo te parashikuar ne kete statut do te respektohen normat ligjore te legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 24.3. Gjykate kompetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarreveshjeve qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise, ose gjate periudhes se likujdimit ndermjet ortakeve, ndermjet shoqerise dhe ortakeve, apo ndermjet shoqerise dhe te treteve, do te jete Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiskionit te Pergjithshem Shkoder.
- 24.4. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti bëhen sipas procedurës së njejtë si është aprovuar.

NENI 25

DISPOZITA TE FUNDIT

- 25.1 Per te gjitha çeshtjet qe nuk gjejne rregullim ne kete Statut, aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
- 25.2 Per efekt te interpretimit te ketij Statuti me ligj tregtar nenkuptohet ligji nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"
- 25.3 Pavlefshmerite eventuale te dispozitave te veçanta te Statutit nuk mund te cenojne vlefshmerine ne teresi te tij.



A202404376005072612

ORTAKET

KRISTJAN LAZRI

Kristjan Lazri

PASHKO KOJA

Pashko Kojer

[Signature]